



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 17.09.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.09.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, montimi dhe servisi i kondicionerëve në shkollë", Nr. i prokurimit- 632-25-6413-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-092-121, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., e dt.15.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, montimi dhe servisi i kondicionerëve në shkollë", Nr. i prokurimit- 632-25-6413-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-092-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 10.09.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.**
- 2. Anullohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:10.09.2025;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.**

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "INFINITT " SH.P.K., me dt.15.09.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe servisimi i kondicionerëve në shkolla ", Nr. i prokurimit- 632-25-6413-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-092-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 17.09.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:


Pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara, prandaj Autoriteti kontraktues do ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
